

URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 184, datë 3.8.2026

PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE PËR KËRKIM – SHPËTIMIN NË
AVIACIONIN CIVIL

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 10 435, datë 23.6.2011, “Për shërbimin e kërkim – shpëtimit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJMË:

1. Miratimin e standardeve për kërkim-shpëtimit në aviacionin civil, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre standardeve gjatë ofrimit të shërbimit të kërkimit dhe shpëtimit, për sa i takon funksioneve të ofrimit të shërbimit SAR, në situata emergjence të avionëve apo personave përkatës në bord të avionit.
3. Ngarkohet struktura përgjegjëse e koordinimit të shpëtimit për ofrimin e shërbimit të kërkim – shpëtimit, në veçanti Qendra Kombëtare e Kërkim – Shpëtimit, për zbatimin e standardeve të miratuara me këtë urdhër.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi

MINISTËR I MBROJTJES
Ermal Nufi

STANDARDET PËR KËRKIM – SHPËTIMIN
NË AVIACIONIN CIVIL

(Miratuar me urdhër të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministrit të
Mbrojtjes nr. _____, datë _____.____.2026)

Tiranë, më ____ . ____ .2026

TABELA E PËRMBAJTJES

KREU I: PËRKUFIZIME

KREU II: ORGANIZIMI

2.1 Shërbimet e kërkim-shpëtimit

2.2 Rajoni i kërkim-shpëtimit

2.3 Struktura përgjegjëse e koordinimit të shpëtimit dhe nënqendrat e shpëtimit..

2.4 Komunikimet e kërkim-shpëtimit

2.5 Njësitë e kërkim-shpëtimit

2.6 Pajisjet e kërkim-shpëtimit

KREU III: BASHKËPUNIMI

3.1 Bashkëpunimi ndërmjet shteteve

3.2 Bashkëpunimi me shërbimet e tjera

3.3 Shpërndarja e informacionit

KREU IV: MASAT PËRGATITORE

4.1 Informacioni përgatitor

4.2 Planet e operimit

4.3 Njësiti e kërkim-shpëtimit

4.4 Stërvitje dhe ushtrime.

4.5 Rrënojat.

(E aplikueshme deri në 25 nëntor 2026)

4.5 Vendet e aksidentit dhe rrënojat.

(E aplikueshme nga 26 Nëntori 2026)

KREU V: PROCEDURAT E OPERIMIT

5.1 Informacion në lidhje me emergjencat

5.2 Procedurat për strukturën përgjegjëse të koordinimit të shpëtimit gjatë fazave të emergjencës

5.3. Procedurat ku përgjegjësia për operacionet shtrihet në dy ose më shumë shtete

5.4 Procedurat për autoritetet në terren

5.5 Procedurat për strukturën përgjegjëse e koordinimit të shpëtimit, përfundimi dhe pezullimi të operacioneve

5.6 Procedurat në vendngjarjen e një aksidenti

5.7 Procedurat për një pilot në komandë që vëren një transmetim rreziku

(E zbatueshme deri në 25 nëntor 2026)

5.7 Procedurat për një pilot në komandë që vëren një transmetim rreziku

(E zbatueshme nga 26 nëntori 2026)

5.8 Sinjalet e kërkim-shpëtimit

5.9 Mirëmbajtja e të dhënave

SHTOJCË. SINJALET E KËRKIMIT DHE SHPËTIMIT

KAPITULLI I PËRKUFIZIME

Termat, shprehjet, dhe shkurtime të përdorura në këtë urdhër kanë kuptimet si në vijim:

Post alarmi është çdo strukturë që synon të shërbejë si një ndërmjetës midis një personi që raporton një emergjencë dhe një qendre të koordinimit të shpëtimit ose nënqendrës së shpëtimit.

Faza e Alarmit është një situatë kur mendohet se mjeti ajror/detar dhe personat në bordin e tij ose njësia tokësore janë të pasigurta.

Faza e rrezikut është një situatë në të cilën ekziston një bindje e arsyeshme dhe është e sigurt se personi/personat apo mjeti ajror/detar dhe personat në bordin e tij gjenden në rrezik serioz ose kanë nevojë për ndihmë të menjëhershme.

Ulje mbi ujë është ulja e detyruar e një avionit mbi ujë.

Faza e emergjencës është një term i përgjithshëm që nënkupton, sipas rastit, fazën e pasigurisë, fazën e vigjilencës, ose fazën e rrezikut.

JRCC është Qendra e Përbashkët e Koordinim-Shpëtimit, përgjegjëse për operacionet aeronautike dhe detare të kërkimit e të shpëtimit.

Operatori është një person, organizatë ose subjekt i angazhuar ose që ofron të angazhohet në një operim avioni.

Piloti në komandë është piloti i caktuar nga operatori, ose në rastin e aviacionit të përgjithshëm, pronari, si komandant dhe i ngarkuar për kryerjen e sigurt të një fluturimi.

Shpëtim është një operacion për të shpëtuar personat në rrezik, për të siguruar nevojat e tyre fillestare mjekësore ose të tjera dhe për t'i dorëzuar ata një vend të sigurtë.

“RCC” është Qendra e Koordinimit të Shpëtimit, njësi përgjegjëse e organizimit të shërbimeve të kërkim-shpëtimit dhe për koordinimin e kryerjes së operacioneve të kërkimit e të shpëtimit brenda një rajoni kërkimi dhe shpëtimi.

Nënqendra e shpëtimit (NQSH) është një njësi në varësi të një qendre koordinimi të shpëtimit, e krijuar për të ndihmuar këtë të fundit sipas dispozitave të veçanta të autoriteteve përgjegjëse.

Kërkim është një operacion i koordinuar zakonisht nga një qendër e koordinimit të shpëtimit ose nga nënqendra e shpëtimit duke përdorur personelin dhe pajisjet e disponueshme për të lokalizuar personat në rrezik.

Avion kërkimi dhe shpëtimi është çdo mjet i përcaktuar si avion sipas përkufizimit të Kodit Ajaoror, i pajisur me pajisje të specializuara të përshtatshme për kryerjen efikase të misioneve të kërkimit dhe shpëtimit.

Strukturë e kërkimit dhe shpëtimit është çdo aset i lëvizshëm, duke përfshirë njësitë e përcaktuara të kërkimit dhe shpëtimit, që përdoret për të kryer operacione kërkim-shpëtimi.

Shërbimi i kërkim-shpëtimit është kryerja e funksioneve të monitorimit të rreziqeve, komunikimit, koordinimit dhe kërkim-shpëtimit, ndihmës mjekësore fillestare ose evakuimit mjekësor, nëpërmjet përdorimit të aseteve publike dhe private, duke përfshirë avionët bashkëpunues, anijet dhe mjetet dhe strukturat e tjera.

Rajoni i Kërkimit dhe Shpëtimit (RKSH) është një zonë me përmasa të përcaktuara, e lidhur me një qendër koordinimi të shpëtimit, brenda së cilës ofrohen shërbimet e kërkim-shpëtimit.

Njësia e kërkim-shpëtimit është një aset i lëvizshëm i përbërë nga personel i trajnuar dhe i pajisur me pajisje të përshtatshme për kryerjen e shpejtë të operacioneve të kërkim-shpëtimit.

Shteti i Regjistrimit është shteti në regjistrin e të cilit është regjistruar avioni.

Faza e paqartësisë/pasigurisë është një situatë kur ekziston paqartësia për sigurinë e mjetit ajror dhe të personave në bordin e tij.

KAPITULLI II ORGANIZIMI

2.1 Shërbimet e kërkim-shpëtimit

2.1.1 Ofrimi i shërbimeve të kërkim – shpëtimit në Republikën e Shqipërisë organizohet me qëllim që ndihma t'u jepet personave në rrezik në incidentet dhe aksidentet e aviacionit civil. Këto shërbime ofrohen individualisht ose në bashkëpunim me shtetet tjera të rajonit dhe do të jenë në dispozicion 24/7 përmes institucioneve përkatëse.

2.1.1.1 Pjesët në det të hapur ose zonat me sovranitet të pacaktuar për të cilat do të ngrihen shërbimet e kërkim – shpëtimit, do të përcaktohen në bazë të marrëveshjeve rajonale të lundrimit ajror. AAC në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit, individualisht ose në bashkëpunim me Shtetet e tjera, do të sigurohen që shërbimet të ngrihen dhe ofrohen në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Shprehja “marrëveshjet rajonale të lundrimit ajror” i referohet marrëveshjeve të miratuara nga Këshilli i ICAO-s, zakonisht sipas këshillave të Takimeve Rajonale të Lundrimit Ajror.

2.1.1.2 Elementet bazë të shërbimeve të kërkim – shpëtimit përfshijnë një kuadër ligjor, një autoritet përgjegjës, asetet e organizuara në dispozicion, struktura komunikimi dhe një fuqi punëtore të aftë për koordinim dhe funksione operacionale.

2.1.1.3 Shërbimet e kërkim-shpëtimit do të krijojnë procese për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve, duke përfshirë aspektet e planifikimit, marrëveshjet dhe trajnimet e bashkëpunimit vendas dhe ndërkombëtar.

2.1.2 Ofrimi i ndihmës për avionët në rrezik dhe për të mbijetuarit e aksidenteve aeronautike, do të kryhet pavarësisht nga kombësia ose statusi i personave të tillë ose rrethanat në të cilat ndodhen këta persona.

2.1.3 Njësitë e kërkim-shpëtimit dhe strukturat e tjera të disponueshme do të përdoren për të ndihmuar çdo avion ose pasagjerë të tij që janë ose duket se janë në një gjendje emergjence.

2.1.4 Kur qendrat e veçanta të koordinimit të shpëtimit aeronautik dhe detar i shërbejnë të njëjtës zonë, do të garantohet koordinimi praktik më i ngushtë i mundshëm ndërmjet qendrave.

2.1.5 Qendra Kombëtare e Kërkim – Shpëtimit duhet të lehtësojë përputhshmërinë dhe bashkëpunimin ndërmjet shërbimeve të tjera të kërkim – shpëtimit aeronautik dhe detar.

2.1.6 Kur është e mundur mund të krijohen qendra të përbashkëta koordinuese të shpëtimit për të koordinuar operacionet e kërkim-shpëtimit aero-detar dhe detar.

2.2 Rajoni i kërkim-shpëtimit

2.2.1 Rajoni i kërkim – shpëtimit nuk duhet të mbivendoset dhe rajonet fqinje duhet të jenë në vazhdimësi.

2.2.2 Rajoni i kërkim-shpëtimit ngrihet për të siguruar praninë e infrastrukturës së përshtatshme të komunikimit, kalimin efikas të alarmit të rrezikut dhe koordinimin e duhur operacional për të mbështetur në mënyrë efektive shërbimet e kërkim – shpëtimit.

2.2.3 Shtetet fqinje mund të bashkëpunojnë për të krijuar shërbime të kërkim-shpëtimit brenda një rajoni të vetëm RSH.

2.2.4 Përcaktimi i rajonit të kërkim-shpëtimit përcaktohet në bazë të vlerësimeve teknike dhe operationale dhe nuk lidhet me përcaktimin e kufijve ndërmjet shteteve.

2.2.5 Rajoni i kërkim – shpëtimit, për aq sa është e mundur, duhet të përkohet me rajonet përkatëse të informacionit të fluturimit dhe, në lidhje me ato zona mbi det të hapur, rajonet e kërkimit dhe shpëtimit detar.

2.3 Struktura përgjegjëse e koordinimit të shpëtimit dhe nënqendrat e shpëtimit

Struktura përgjegjëse e koordinimit të shpëtimit mund të jetë e lidhur me një rajon kërkim-shpëtimi, i cili, në përputhje me marrëveshjet rajonale të lundrimit ajror, shtrihet në një zonë më të madhe se hapësira ajrore e tij sovranë.

2.3.2 Kur e gjitha ose një pjesë e hapësirës ajrore e Republikës së Shqipërisë përfshihet në një rajon kërkim-shpëtimi, të lidhur me një qendër koordinimi të shpëtimit në një Shtet tjetër, Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit duhet të krijojë një nënqendër shpëtimi të varur nga struktura përgjegjëse e koordinimit të shpëtimit kudo që kjo do të përmirësonte efikasitetin e shërbimeve të kërkim-shpëtimit brenda territorit të tij.

2.3.3 Struktura përgjegjëse e koordinimit të shpëtimit dhe, sipas rastit, nënqendër e shpëtimit, do të kenë 24 orë në ditë staf të trajnuar dhe të aftë në përdorimin e gjuhës së përdorur për komunikimet radiotelefonike.

2.3.4 Personeli i strukturës përgjegjëse të koordinimit të shpëtimit, i përfshirë në kryerjen e komunikimeve radiotelefonike duhet të jetë i aftë në përdorimin e gjuhës angleze.

2.3.5 Në zonat ku pajisjet publike të telekomunikacionit nuk lejojnë personat që vëzhgojnë një avion në rast emergjence të njoftojnë strukturën përgjegjëse të koordinimit të shpëtimit në fjalë drejtpërdrejt dhe menjëherë, duhet të caktohen njësi të përshtatshme të shërbimeve publike ose private si post lajmërimi.

2.3.6 Struktura përgjegjëse e koordinimit të shpëtimit dhe, sipas rastit, nënqendër e shpëtimit do të mbajë kontakte të përditësuara në Drejtorinë e Kontrollit të OPS.

2.3.7 Struktura përgjegjëse e koordinimit të shpëtimit dhe, sipas rastit, nënqendër e shpëtimit do të pajtohet dhe do të mbajë aksesin në bazen e të dhënave për vendndodhjen e avionëve në rrezik (LADR).

Udhëzime mbi përdorimin e Drejtorisë së Kontrollit të Ops dhe të LADR-së jepen në Manualin mbi Sistemin Global të Rrezikut Aeronautik dhe Sistemit të Sigurisë në Operim (GADSS) (Doc 10165).

2.4 Komunikimet e kërkim – shpëtimit

2.4.1 Struktura përgjegjëse e koordinimit të shpëtimit duhet të ketë mjete të komunikimit të dyanshëm, të shpejtë dhe të besueshme me:

- a) njësitë përkatëse të shërbimeve të trafikut ajror;
- b) nënqendrat vartëse të shpëtimit;
- c) stacionet e duhura për gjetjen e drejtimit dhe fiksimin e pozicionit;
- ç) sipas rastit, radiostacionet bregdetare të aftë për të lajmëruar dhe komunikuar me mjetet e sipërfaqes në rajon;
- d) shtabin e njësive të kërkim-shpëtimit në rajon;
- dh) të gjitha qendrat e koordinimit të shpëtimit detar në rajon dhe qendrat e koordinimit të shpëtimit aeronautik, detar ose të përbashkët në rajonet ngjitur;
- e) një zyrë të caktuar meteorologjike ose një zyrë vëzhgimi meteorologjik;
- ë) njësitë e kërkim – shpëtimit;
- f) postat e lajmërimit; dhe
- g) Qendrën e Kontrollit të Misionit Cospas – Sarsat që shërben në rajonin e kërkim – shpëtimit.

Qendrat koordinuese të shpëtimit detar janë identifikuar në dokumentet përkatëse të Organizatës Ndërkombëtare Detare.

2.4.2 Struktura përgjegjëse e koordinimit të shpëtimit duhet të ketë mjete të komunikimit të dyanshëm, të shpejtë dhe të besueshëm me:

- a) nënqendrat e shpëtimit ngjitur me të;
- b) një zyrë meteorologjike ose një zyrë vëzhgimi meteorologjik;
- c) njësitë e kërkim – shpëtimit; dhe
- d) postat e lajmërimit.

2.5 Njësitë e kërkim-shpëtimit

2.5.1 Ministria e Mbrojtjes përcakton si njësi të kërkim – shpëtimit elementë publikë ose privatë të vendosura dhe pajisura në mënyrë të përshtatshme për operacionet e kërkim – shpëtimit:

Njësitë dhe strukturat minimale të nevojshme për ofrimin e operacioneve të kërkim – shpëtimit brenda një rajoni të kërkim – shpëtimit përcaktohen nga marrëveshjet rajonale të lundrimit ajror dhe janë të specifikuara në publikimet përkatëse të Planit të Lundrimit Ajror dhe Dokumentit për Zbatimin e Shërbimeve dhe Strukturave.

2.5.2 Ministria e Mbrojtjes, përgatit Planin Kombëtar të Kërkim – Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë, në të cilin do të përcaktojë elementet publike ose private të cilat nuk kualifikohen si njësi kërkim – shpëtimi, por megjithatë janë në gjendje të marrin pjesë në operacionet e kërkim – shpëtimit.

2.6 Pajisjet e kërkim-shpëtimit

2.6.1 Njësitë e kërkim-shpëtimit duhet të pajisen me pajisje për lokalizimin e menjëhershëm dhe për ofrimin e ndihmës së përshtatshme në vendin e aksidentit.

2.6.2 Çdo njësi kërkim-shpëtimi duhet të ketë mjete të komunikimit të dyanshëm, të shpejtë dhe të besueshëm, me strukturat e tjera të kërkim-shpëtimit të përfshira në të njëjtin operacion.

2.6.3 Çdo avion kërkimi dhe shpëtimi duhet të jetë i pajisur për të qenë në gjendje të komunikojë në frekuencat aeronautike të rrezeve dhe ato të vendngjarjes dhe në frekuenca të tjera që mund të përcaktohen.

2.6.4 Çdo avion kërkimi dhe shpëtimi duhet të pajiset me një pajisje për të lokalizuar frekuencat e fatkeqësisë.

Kërkesat e mbajtjes së transmetuesit të lokalizimit të urgjencës (TLU) janë dhënë në aneksin 6, Ppjesët I, II dhe III.

Specifikimet për TLU jepen në aneksin 10, vëllimi III.

2.6.5 Çdo avion kërkimi dhe shpëtimi, kur përdoret për kërkim dhe shpëtim mbi zonat detare, duhet të jetë i pajisur me mjete komunikimi që të jetë në gjendje të komunikojë me anije.

Deri në 25 nëntor 2026, shumë anije mund të komunikojnë me avionët në 2182 kHz, 4125 kHz dhe 121.5 MHz. Megjithatë, këto frekuenca, dhe në veçanti 121.5 MHz, mund të mos monitorohen rregullisht nga anijet.

Nga 26 nëntori 2026, shumë anije mund të komunikojnë me avionët në 2182 kHz, 4125 kHz dhe 121.5 MHz dhe 123.1 MHz. Megjithatë, këto frekuenca, dhe në veçanti 121.5 MHz dhe 123.1 MHz, mund të mos monitorohen rregullisht nga anijet. Në vend të tyre, anijet monitorojnë Kanalin 16 (156.8 MHz), frekuencën ndërkombëtare detare për rreziqet, sigurinë dhe komunikimet hyrëse.

2.6.6 Çdo avion kërkimi dhe shpëtimi, kur përdoret për kërkim dhe shpëtim në zonat detare, duhet të mbajë një kopje të Kodit Ndërkombëtar të Sinjaleve për të mundësuar tejkalimin e vështirësive gjuhësore që mund të hasen në komunikimin me anijet.

Kodi Ndërkombëtar i Sinjaleve botohet në anglisht, frëngjisht dhe spanjisht nga Organizata Ndërkombëtare Detare në formën e dokumenteve I994E, I995F dhe I996S.

2.6.7 Përveç rasteve kur dihet se nuk ka nevojë të sigurohen furnizime për të mbijetuarit nga ajri, të paktën një avion që merr pjesë në një operacion kërkim – shpëtimi duhet të mbajë pajisje mbijetese të lëshueshme.

2.6.8 Ministria e Mbrojtjes do të vendosë, në aerodromet e përshtatshme pajisje mbijetese të paketuara në mënyrë të përshtatshme për t'u lëshuar nga avioni.

2.6.9 Që nga 26 nëntor 2026, çdo avion kërkimi dhe shpëtimi, kur përdoret për kërkim-shpëtim mbi zonat detare, duhet të ketë një pajisje të lëshueshme për matjen e shmagies aktuale të sipërfaqes së ujit.

KAPITULLI III BASHKËPUNIMI

3.1 Bashkëpunimi ndërmjet shteteve

3.1.1 Ministria e Mbrojtjes nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit do të koordinojë organizatat e saj të kërkim – shpëtimit me ato të shteteve fqinje.

3.1.2 Operacionet e kërkim-shpëtimit duhet, kurdo që është e nevojshme, të bashkërendohen me ato të shteteve fqinje, veçanërisht kur këto operacione janë afër rajoneve të kërkim-shpëtimit në vazhdimësi.

3.1.2.1 Për aq sa është e mundur, do të zhvillohen plane të përbashkëta për kërkimin dhe shpëtimin dhe procedura për të lehtësuar koordinimin e operacioneve të kërkimit dhe shpëtimit me ato të shteteve fqinje.

3.1.3 Në varësi të kushteve që mund të përcaktohen nga ligji për kërkim shpëtimin do të lejohet hyrja e menjëhershme në territorin e Republikës së Shqipërisë të njësive të kërkim-shpëtimit të shteteve të tjera me qëllim të kërkimit të vendit të aksidenteve të avionëve dhe shpëtimit të të mbijetuarve të këtyre aksidenteve.

3.1.4 Ministria e Mbrojtjes nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Kërkim – Shpëtimit në rast se dëshiron që njësitë e saj të kërkim – shpëtimit të hyjnë në territorin e një Shteti tjetër për qëllime kërkimi dhe shpëtimi, do të dërgojë një kërkesë, duke dhënë detaje të plota të misionit të parashikuar dhe nevojën për të, tek qendra e koordinimit të shpëtimit të Shtetit në fjalë ose një autoritet tjetër që është caktuar nga ai Shtet.

Në të dyja rastet operacionet e kërkim shpëtimit drejtohen nga strukturat operationale të kërkim shpëtimit të vëndëve ku kryhen misionet e kërkim – shpëtimit.

3.1.4.1 Në rastin kur një kërkesë e tillë vjen nga një qëndër e huaj për Shqipërinë, Qendra Kombëtare të Kërkim – Shpëtimit në Ministrinë e Mbrojtjes do të:

- pranojnë menjëherë marrjen e një kërkesë të tillë, dhe
- sa më shpejt të jetë e mundur, të tregojnë kushtet, nëse ka, në të cilat mund të ndërmerret misioni i parashikuar.

3.1.5 Me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimin e kërkim – shpëtimit do të lidhen marrëveshje me shtetet fqinje, duke përcaktuar kushtet për hyrjen e njësive të kërkim – shpëtimit të njëri-tjetrit në territoret e tyre përkatëse. Këto marrëveshje duhet gjithashtu të parashikojnë përsheptimin e hyrjes së njësive të tilla me sa më pak formalitete të mundshme.

3.1.6 Qendra Kombëtare e Kërkim – Shpëtimit autorizohet që:

a) të kërkojë nga qendrat e koordinimit të shpëtimit të vendeve fqinje një ndihmë të tillë, duke përfshirë avionët, anijet, personat ose pajisjet, sipas nevojës;

b) të japë çdo leje të nevojshme për hyrjen e këtyre avionëve, anijeve, personave ose pajisjeve në territorin e tij; dhe

c) të bëjë marrëveshjet e nevojshme me autoritetet përkatëse doganore, të emigracionit ose autoritetet e tjera me synimin për të përsheptuar një hyrje të tillë.

3.1.7 Qendra Kombëtare e Kërkim – Shpëtimit do të autorizohet për të ofruar, kur kërkohet ndihmë nga qendrat e tjera të koordinimit të shpëtimit të vendeve fqinje, duke përfshirë ndihmën në formën e avionëve, anijeve, personave ose pajisjeve.

3.1.8 Deri në 25 nëntor 2026, me qëllim promovimin e efikasitetit të kërkim – shpëtimit duhet të merren masa për stërvitje të përbashkëta trajnimi që përfshijnë njësitë e kërkim – shpëtimit brenda vendit, si dhe ato të shteteve dhe operatorëve të tjerë.

3.1.8 Nga 26 nëntori 2026, me qëllim promovimin e efikasitetit të kërkim – shpëtimit duhet të merren masa për stërvitje të përbashkëta trajnimi që përfshijnë qendrat e koordinimit të shpëtimit, nënqendrat e shpëtimit dhe njësitë e kërkim – shpëtimit, brenda vendit, si dhe ato të Shteteve dhe operatorëve të tjerë.

3.1.9 Duhet të bëhen marrëveshje për vizita periodike ndërlidhëse nga personeli i Qendrës Kombëtare të Kërkim – Shpëtimit dhe nënqendrave të saj të Kërkim – Shpëtimit me qendrat e shteteve fqinje.

3.2 Bashkëpunimi me shërbimet e tjera

3.2.1 Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit do të marrë masa që të gjithë avionët, anijet dhe shërbimet dhe strukturat lokale që nuk janë pjesë e organizatës së kërkim-shpëtimit, të bashkëpunojnë plotësisht me këto të fundit në kërkim – shpëtim dhe të ofrojnë çdo ndihmë të mundshme për të mbijetuarit e aksidenteve të avionëve.

3.2.2 Duhet të sigurohet koordinimi më i afërt i mundshëm ndërmjet autoriteteve përkatëse aeronautike dhe detare për të ofruar shërbimet më efektive dhe efikase të kërkim – shpëtimit.

3.2.3 Qendra Kombëtare e Kërkim – Shpëtimit do të sigurojë që shërbimet e tyre të kërkimit dhe shpëtimit të bashkëpunojnë me ata që janë përgjegjës për hetimin e aksidenteve dhe me ata që janë përgjegjës për kujdesin e atyre që kanë vuajtur nga aksidenti.

3.2.4 Për të lehtësuar hetimin e aksidentit, njësitë e shpëtimit, kur është e mundur, duhet të shoqërohen nga persona të kualifikuar në kryerjen e hetimeve të aksidenteve ajrore.

3.2.5 Struktura përgjegjëse e koordinimit të shpëtimit caktohet si Pikë Kombëtare Kontakti Kërkimi dhe Shpëtimi (SPOC) për marrjen e të dhënave të rrezikut nga Cospas-Sarsat, në dispozicion 24 orë në ditë, që të sigurojë njoftimin në kohë të strukturave operacionale të kërkim – shpëtimit për fillimin e operacioneve të kërkim – shpëtimit.

3.3 Shpërndarja e informacionit

3.3.1 Qendra Kombëtare e Kërkim – Shpëtimit do të publikojë dhe shpërndajë të gjithë informacionin e nevojshëm për hyrjen e njësive të kërkimit dhe shpëtimit të shteteve të tjera në territorin e Republikës së Shqipërisë ose, në mënyrë alternative, të përfshijnë këtë informacion në marrëveshjet për shërbimin e kërkim-shpëtimit.

3.3.2 Kur nga një informacion i tillë mund të përfitojë ofrimi i shërbimeve të kërkim – shpëtimit, duhet vënë në dispozicion, nëpërmjet qendrave të koordinimit të shpëtimit ose agjencive të tjera, informacion në lidhje me planet e tyre për operacionet e kërkim – shpëtimit.

3.3.3 Për aq sa është e mundur, duhet shpërndarë informacioni për publikun e gjerë dhe autoritetet e reagimit ndaj emergjencave, në lidhje me veprimet që duhen ndërmarrë, kur ka

arsye për të besuar, se situata emergjente e një avioni, mund të bëhet shkak për shqetësim publik ose kërkojnë një përgjigje të përgjithshme emergjente.

KAPITULLI IV MASAT PËRGATITORE

4.1 Informacioni përgatitor

4.1.1 Qendra Kombëtare e Kërkim – Shpëtimit duhet të ketë në dispozicion në çdo kohë informacion të përditësuar në lidhje me sa vijon për sa i përket rajonit të saj të kërkim – shpëtimit:

- a) njësité e kërkim – shpëtimit, nënqendrat e shpëtimit dhe postat e lajmërimit;
- b) njësité e shërbimeve të trafikut ajror;
- c) mjetet e komunikimit që mund të përdoren në operacionet e kërkim – shpëtimit;
- d) adresat dhe numrat e telefonit të të gjithë operatorëve, ose përfaqësuesve të tyre të caktuar, të angazhuar në operacione në rajon; dhe
- e) çdo burim tjetër publik dhe privat, duke përfshirë strukturat mjekësore dhe transportuese që ka të ngjarë të jenë të dobishme në kërkim dhe shpëtim.

4.1.2 Struktura përgjegjëse e koordinimit të shpëtimit duhet të ketë në dispozicion të gjitha informacionet e tjera me interes për kërkimin dhe shpëtimin, duke përfshirë informacionin në lidhje me:

- a) vendndodhjet, shenjat e thirrjes, orët e rojes dhe frekuencat e të gjitha stacioneve radio që mund të përdoren në mbështetje të operacioneve të kërkim – shpëtimit;
- b) vendndodhjet dhe orët e rojes të shërbimeve që mbajnë nën vëzhgim frekuencat e radios dhe frekuencat e vëzhguara;
- c) vendndodhjet ku ruhen furnizimet e pajisjeve të urgjencës dhe të mbijetesës që mund të lëshohen nga avioni; dhe
- ç) strukturat për të cilat dihet se mund të ngatërrohen dhe konsiderohen si rrënoja të pagjetura ose të paraportuara, veçanërisht nëse shihen nga ajri.
- d) nga 26 nëntori 2026, pozicionin, kursin dhe shpejtësinë e avionëve që mund të jenë në gjendje të ofrojnë ndihmë për avionët në rrezik; dhe
- dh) nga 26 nëntori 2026, kur rajoni i kërkim – shpëtimit përfshin zonat detare, pozicionin, kursin dhe shpejtësinë e anijeve që mund të jenë në gjendje të ofrojnë ndihmë për avionët në rrezik.

4.1.3 Deri në 25 nëntor 2026, struktura përgjegjëse e koordinimit të shpëtimit, rajoni i kërkim-shpëtimit i së cilës përfshin zonat detare, duhet të ketë akses të menjëhershëm në informacion në lidhje me pozicionin, kursin dhe shpejtësinë e anijeve brenda zonave të tilla që mund të jenë në gjendje të ofrojnë ndihmë për avionët në fatkeqësi dhe informacion si të kontaktojnë me to.

Ky informacion ose mund të ruhet në strukturën përgjegjëse të koordinimit të shpëtimit ose të jetë lehtësisht i referueshëm.

4.1.4 Qendra Kombëtare e Kërkim – Shpëtimit duhet, individualisht ose në bashkëpunim me Shtetet e tjera, ose të krijojnë sisteme raportimi të anijeve në bashkëpunim me autoritetet detare ose të organizojnë lidhje komunikimi me Amver ose sistemet rajonale të raportimit të anijeve për të lehtësuar operacionet e kërkim – shpëtimit në det.

Amver është një sistem bashkëpunimi ndërkombëtar i raportimit të anijeve me mbulim mbarëbotëror që është i disponueshëm për t'u konsultuar nga të gjitha qendrat e koordinimit të shpëtimit. Një numër shtetesh kontraktuese operojnë gjithashtu sisteme rajonale të raportimit të anijeve.

4.2 Planet e operimit

4.2.1 Struktura përgjegjëse e koordinimit të shpëtimit do të përgatisë plane të detajuara operimi për kryerjen e operacioneve të kërkim – shpëtimit brenda rajonit të saj të kërkim – shpëtimit.

4.2.2 Planet e operimit të kërkim – shpëtimit duhet të zhvillohen së bashku me përfaqësuesit e operatorëve dhe shërbime të tjera publike ose private që mund të ndihmojnë në ofrimin e shërbimeve të kërkim – shpëtimit ose të përfitojnë prej tyre, duke marrë parasysh që numri i të mbijetuarve mund të jetë i lartë.

4.2.3 Planet e operimit do të specifikojnë masat për shërbimin dhe furnizimin me karburant, për aq sa është e mundur, të mjeteve ajrore, anijeve dhe automjeteve të përdorura në operacionet e kërkim – shpëtimit, duke përfshirë ato të vëna në dispozicion nga Shtetet e tjera.

4.2.4 Planet e operimit të kërkim – shpëtimit duhet të përmbajnë detaje në lidhje me veprimet që duhet të ndërmerren nga ata persona të përfshirë në kërkim – shpëtim, duke përfshirë:

a) mënyrën se si do të kryhen operacionet e kërkim – shpëtimit në rajonin e kërkim-shpëtimit;

b) përdorimin e sistemeve dhe strukturave të disponueshme të komunikimit;

c) veprimet që do të ndërmerren së bashku me qendrat e tjera të koordinimit të shpëtimit;

ç) metodat e lajmërimit të avionëve në fluturim e sipër dhe anijeve në det;

d) detyrat dhe përgjegjësitë e personave të caktuar për kërkim – shpëtim;

dh) rivendosjen e mundshme të pajisjeve që mund të jetë bërë e nevojshme nga kushtet meteorologjike ose të tjera;

e) metodat për marrjen e informacionit thelbësor në lidhje me operacionet e kërkim-shpëtimit, të tilla si raportet dhe parashikimet e motit, NOTAM-in përkatës, etj.;

ë) metodat për marrjen, nga qendrat e tjera të koordinimit të shpëtimit, të një ndihme të tillë, duke përfshirë avionët, anijet, personat ose pajisjet, sipas nevojës;

f) metodat për të ndihmuar avionët në rrezik që detyrohen të ulen mbi ujë për t'u takuar me mjetet mbi sipërfaqen e ujit;

g) metodat për të ndihmuar kërkim – shpëtimin ose avionët e tjerë për të shkuar drejt avionit në rrezik; dhe

